



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE
E.G BAILIFF'S SERVICES

Adresa: Rr" Bogdanëve", Godina "Eurocol", Kati V, Nr.34, Tiranë Cel- +355 67 20 27 580, Tel +355 4 22 31 888

Nr. 2926 .Prot

Tiranë më 30.05.2016

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT

TIRANË

Në Tiranë sot më datë 30.05.2016.

Unë **Enuar MERKO** Përmbaues Gjyqësor Privat dhe Administrator i **Shoqërisë Përmbaues Gjyqësore Private "E.G BAILIFF'S SERVICES" sh.p.k** pasi studiova dosjen përmbaues Nr.371 datë 05.05.2016 si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.813/U datë 08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KONSTATOVA

Shoqëria "Antea Cement" sh.a në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë **Shoqërisë Përmbaues Gjyqësore Private "E.G BAILIFF'S SERVICES" shpk**, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendim Gjyqësor Nr.813 datë.08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit Nr813/U datë 08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë:

- **Kreditor** : Shoqëria "ANTEA CEMENT" sh.a
- **Debitor** : Shoqëria "BLERALD" sh.p.k
- **Me objekt** : Kthim Shume

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv, Vendim Gjyqësor Nr.813 datë.08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendim të Përmbauesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, Vendim Gjyqësor Nr.813 datë.08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte për ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv, Titullit Ekzekutiv, Vendim Gjyqësor Nr.813 datë.08.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të kryhet çbllokimi mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga debitori **Shoqëria "BLERALD" sh.p.k**



identifikuar me Nipt: L11521004F me përfaqësues ligjor z. Armando Pajtoni me qëllim shlyerjen e detyrimit.

Nga sa më sipër si dhe mbështetur në nenin 527,540 të Kodit Proçedurës Civile dhe në nenet 31 gërma b, 32 gërma c dhe nenin 46 të Ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

URDHËROJMË

1. Vendosijen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga debitori Shoqëria ‘BLERALD’ sh.p.k identifikuar me Nipt: L11521004F me përfaqësues ligjor z. Armando Pajtoni.
2. Pas vendosjes së sekuestros konservative, të informohemi në lidhje me:
 - a) adresën e ushtrimit të veprimtarisë private
 - b) llojin e aktivitetit për të cilin është pajisur me liçencë
 - c) bllokimin e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimit të aktivitetit.
3. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
4. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE

“E.G BAILIFF’S SERVICES” sh.p.k

PËRMBARUES GJYQËSOR

ENUAR MERKO